

Gerta Lubonja

Drejtori i Përgjithshëm

Znj. Gerta Lubonja ka lindur në Tiranë, më 14 qershor 1979. Në vitin 2004, ka përfunduar studimet e larta në degën Inxhinieri Hidroteknike pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ka kryer trajnime dhe specializime të ndryshme në fushën e hidroteknikës, menaxhimit të integruar të burimeve ujore, administrimit publik etj.

Në periudhën 2004-2014 ka punuar si inxhinier projektuese dhe ka drejtuar një numër të madh projektesh infrastrukturore, pranë kompanive që ushtronin aktivitetin e tyre në fushën e projektimit dhe supervizionit.

Në vitin 2011 u zgjodh anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës, për një mandat 4 vjeçar, ku shërbeu edhe si drejtuese e “Komisionit të Rregullimit të Territorit”.

Gjatë viteve 2014-2017 ka qenë në krye të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, pranë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, duke ndjekur projekte të ndryshme kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të burimeve ujore.

Gjithashtu, prej vitit 2014, mban pozicionin e Kryetarit të “Komisionit të Posaçëm të Dhënies së Licencave Profesionale për Individë dhe Subjekte Juridikë, në Fushën e Studimit e të Projektimit në Ndërtim dhe Mbikëqyrjes e Kolaudimit të Punimeve të Zbatimit në Ndërtim”, si dhe të Kryetarit të “Komisionit të Posaçëm të Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit”.

Nga tetori i vitit 2017, Znj. Gerta Lubonja mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Ajo është njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe italiane.